



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKISE VAU DEJES



VENDIM

Nr. 07 date 24/01/2020

**Per disa ndryshime dhe plotesime ne VKB Nr. 84, date 25.11.2019 Per "MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2020" NE BASHKINE VAU-DEJES**

Keshilli i Bashkise Vau-dejes, i mbledhur me date 24.01.2020, pasi shqyrtoi projekt-vendimin e paraqitur nga Sektori i te Ardhurave, "Per Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore, per vitin 2020", mbeshtetur ne nenin 18, nenin 35, pika 1, germa a,b,c,dh,e dhe pikat 2,3,4,5, germa a,b,c,ç, neni 36, pika 1 dhe 2, neni 54, germa "f", neni 55, pika 3 te ligjit 139/2015, date 27.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore", Ligjin 9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, "Për liçensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë"; i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar; Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin"; Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje", i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar; Ligjin nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"; Ligjin nr. 68/2017, date 27.04.2017 "Per financat vendore", ne VKM nr. 132, date 07.03.2018 "Per Metodologjine per percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme "ndertesa", e bazes se taksës per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacionit dhe te dhenave per percaktimin e bazes se taksës, si dhe te kritereve dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te taksës", si dhe ne shkresen Nr. 1309/1prot, date 13.12.2019 te Prefektures Shkoder, pika 1 dhe 2,